

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-091/14

**Prishtinë,
2 dhjetor 2015**

Në çështjen juridike të:

B.V.

Vesnik Mira 12, fshati KB

Kruševac, Serbi

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Anna Bednarek, anëtarë, duke vendosur sipas Ankesës së paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA39714), i datës 18 prill 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 dhjetor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e B.V. .
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/196/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA39714), i datës 18 prill 2013.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 21 maj 2007, Ankuesi, B.V. , ka paraqitur një Kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin dhe kompensimin për shfrytëzimin e ¼ pjesë ideale të ngastrës Nr. 1/340, në sipërfaqe prej 00.05.54 ha, në Vidanje, Jelenjak, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: pronë e kërkuar).
2. Për t'i mbështetur pretendimet e tij, Ankuesi ka paraqitur dokumentet si në vijim:
 - Kopjen e fletës poseduese nr.155 e lëshuar me 01.04.2002, lidhur me numrin e ngastrave përfshirë pronën e kërkuar dhe ku përmendet Ankuesi si pronar i ¼ pjesë ideale të saj.
 - Letërnjoftimi i Ankuesit i lëshuar më 13 shtator 1991.
3. Fillimisht njoftimi i pronës është bërë më 25 prill 2008 dhe është gjet jo e zënë.
4. Më 05 shkurt 2013, Ekipi për njoftim e ka bërë përsëri njoftimin e pronës së kërkuar. Sipas raportit të datës së njëjtë, në pronën e kërkuar është gjetur e ndërtuar një shtëpi e re një katesh e me objekte tjera (stallë) dhe është e zënë nga M.K.V. (në tekstin e mëtejme: Pala përgjegjëse në ankesë).
5. Pala përgjegjëse në ankesë ka kërkuar të drejtat ligjore ndaj pronës së kërkuar dhe e ka nënshkruar Njoftimin për pjesëmarrje në datën e njoftimit.
6. Nga Raporti i Konsoliduar Verifikues të datës 07 shkurt 2013, mund të shihet se dokumentet e paraqitura nga Ankuesi janë verifikuar pozitivisht.
7. Ankuesi është kontaktuar më 28 janar 2013 por nuk ka qenë në gjendje të flasë për shkak të gjendjes së tij fizike. Bashkëshortja e Ankuesit, R.V. ka konfirmuar deklaratën e Ankuesit se ngastra e kërkuar është këmbyer në mes të babait të Ankuesit dhe babait të PPK-së para 60 vitesh, por nuk janë bërë ndryshimet në kadastër. Babai i Ankuesit kishte marrë pronën në Klinë/Klina për ngastrën e këmbyer (pronën e kërkuar).
8. KKPK-ja me Vendimin e vet KPCC/D/A/196/2013, të datës 18 prill 2013, **e ka refuzuar** kërkesën sepse humbja e posedimit nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur gjatë viteve 1998/1999 por rezultat i tjetërsimit vullnetar të kësaj prone para konfliktit.
9. Vendimi i është dorëzuar Ankuesit më 17 janar 2014. B.V. ka paraqitur ankesë më 13 shkurt 2014.

Pretendimet e Palës ankuese:

10. Pala ankuese e kundërshton Vendimin e KKPK-së për shkak të vërtetimit jo të plotë të fakteve dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
11. Pala ankuese konfirmon se ka paraqitur kërkesë lidhur me ngastrën Nr.1/340 me sipërfaqe prej 00.05.54 ha, por ka pretenduar se kishte qëllim të kërkonte vërtetimin e të drejtave pronësore ndaj ngastrave Nr. 605/2 dhe Nr.605/3 që ndodhen në qytet në Klinë dhe jo për ngastrat nr.1/340 dhe 1/342, në fshatin Videjë.

12. Pala ankuese gjithashtu e konfirmon se prona e kërkuar është këmbyer në vitin 1954 dhe nuk ka qenë në posedim të familjes së tij menjëherë para dhe gjatë konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/1999.
13. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme t'ia vërtetojë të drejtat pronësore ndaj ngastrave nr.605/2 dhe nr. 605/3 që ndodhen në Klinë.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e Ankesës:

14. Ankesa është e pranueshme. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079).

Meritat

15. Sipas Nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me konfliktin që përfshijnë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
 16. Në këtë lëndë të veçantë, posedimi i pronës së kërkuar është humbur në vitin 1954 (vet pala ankuese e pohon këtë fakt), që nënkupton se kërkesa nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur gjatë viteve 1998/1999. Prandaj, Komisioni duhej ta **hidhte poshtë** kërkesën.
 17. Në vendimin e tij KPCC/D/A/196/2013 të datës 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka vendosur ta hedhë poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit për sa i përket pronës së kërkuar. Në anën tjetër në Vendimin e vet të Vërtetuar shkruan se “kërkesa mbetet **të refuzohet**”.
- Kjo pasaktësi është rezultat i gabimit teknik dhe nuk ndikon në esencën e vendimit.
18. Pala ankuese pretendon se ka pasur keqkuptim gjatë procedimit, sepse qëllimi i tij ka qenë të kërkojë vërtetimin e të drejtës pronësore ndaj ngastrave Nr. 605/2 dhe 605/3, dhe jo ndaj pronës së kërkuar. Ai po ashtu ka thënë se prona e kërkuar është këmbyer në fillim të vitit 1954 dhe se ai nuk është duke e kontestuar këtë fakt.
 19. Kërkesa e palës ankuese për zëvendësimin e çështjes lëndore të kërkesës (vërtetimi i të drejtave pronësore ndaj ngastrave nr.605/2 dhe Nr.605/3 që ndodhen në Klinë/Klina, në vend të ngastrës Nr. 1/340 në Vidanje) është e papranueshme. Prandaj arsyet e paraqitura në Ankesë do të mund që të mos konsiderohen si baza të rëndësishme dhe mund të mos të referojnë në ndryshimin e Vendimit të ankimuar.

20. Neni 11.4(b) i Ligjit 03/L-079 parasheh se “Komisioni duhet të hdehë një pjesë të kërkesës ose kërkesën si tërë atëherë kur kërkesa nuk është në kuadër të juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronës”. Rrjedhimisht, në kontestimin e procedurës para Kolegjit të Apelit kjo domethënë se Gjykata e refuzon Ankesën si të pabazuar dhe e ndryshon *ex officio* Vendimin e ankimuar, për shkak të mospërputhshmërive duke e hedhur Kërkesën.

Konkluzioni

21. Në bazë të arsyeve të lartcekura dhe në pajtim me Nenin 195.1/e) dhe 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, modifikohet Vendimi i KKPK-së dhe hidhet poshtë Kërkesa si e papranueshme për shkak të mungesës së juridiksionit.
22. Në bazë të arsyeve të paraqitura dhe në pajtim me nenin 13.3 (a) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin 03/L-079, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it